

**DRAFT**

**PLANI SOCIAL DHE I MBROJTJES SË FËMIJËVE**

**Bashkia Dibër**

**Shkurt, 2018**

## HYRJE

Territori i Dibrës përshkohet përgjatë gjithë gjatësisë së tij nga Lumi Drin i Zi (më i gjati në Shqipëri) dhe rrethohet nga të dy anët nga vargmali i Korab-Deshat (më i larti në Shqipëri) që është pjesë e parkut natyror Korab-Korritnik dhe vargmalet e Lurë-Selishtë që janë një pjesë e parkut kombëtar të Lurës dhe karakterizohet nga 23 liqene akullnajore. Territori i Dibrës në masën 90% është zonë rurale dhe vetëm 10% e këtij territori është zonë urbane që shtrihet në qytetin e Peshkopisë. Zona rurale përfaqësohet nga 141 fshatra me një diversitet relievi nga fshatra malorë, kodrinorë dhe fushorë kryesisht në luginën e Drinit të Zi.

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 61,619 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 78,940 banorë. Me një sipërfaqe prej 937.88 km<sup>2</sup>, bashkia e re ka densitet popullsie prej 84.16 banorësh/km<sup>2</sup> sipas Regjistrimit Civil dhe 65.70 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011. Popullsia është e shpërndarë në 15 NJQV-ve - 1 bashki dhe 14 komuna me 141 fshatra. Bashkia e Peshkopisë është qendra urbane dhe ka një popullsi prej 20,000 banorësh ndërsa popullsia tjetër banon në zonën rurale të Komunave; Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot, Fushë-Cidhën, Sllovë, Kala e Dodës, Rec, Zall-Dardhë, Arras, Muhurr, Luzni, Selishtë dhe Lurë.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen vendore<sup>1</sup> bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve shoqërore, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve shoqërore vendore.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015 – 2020) cilëson shërbimet e përkujdesit shoqërore si funksion i vet i pushtetit vendor, në përputhje me parashikimet e Ligjit organik të Qeverisjes Vendore (nr. 8652/2000) në fuqi. Gjithashtu strategjia shpreh synimin e qeverisë për decentralizimin e plotë të shërbimeve të përkujdesit shoqërorë, përkundrejt mbështetjes teknike, institucionale dhe financiare nga burimet e buxhetit të shtetit. Në mbështetje të këtij synimi MSHKS ka përgjegjësi dhe rol kryesor në ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme gjatë këtij procesi.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020 synon reformimin e Programit të Mbrojtjes Shoqërore nëpërmjet transformimit të Ndhmës Ekonomike në një skemë aktive të riintegritit social; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë kufizuar; ndërhyrjes dhe riintegritit të fëmijëve në familje e komunitet duke treguar kujdes të veçantë për fëmijët jetimë social dhe biologjikë dhe ofrimin e shërbimeve të integruara. Prioritet është sigurimi i burimeve të nevojshme për grupet më të rrezikuara nëpërmjet Fondit Kombëtar për Shërbimet Shoqërore dhe Fondeve Rajonale për Shërbimet Shoqërore si pjesë e Fondit Shoqëror. Sipas Strategjisë së Mbrojtjes Shoqërore në nivel vendor, bashkitë janë përgjegjëse për vlerësimin dhe planifikimin e nevojave, si dhe shpërndarjen e shërbimeve. Deri më sot, janë vendosur disa themele:

---

<sup>1</sup>Ligji për Vetëqeverisjen Vendore, Nr. 139/2015

- Role dhe përgjegjësi të qarta për bashkitë e formuara rishtazi për planifikimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat janë pasqyruar në ligjin e ri për vetëqeverisjen vendore, strategjine e decentralizimit dhe atë të mbrojtjes sociale.
- Formësimi i konceptit të paketës bazë të shërbimeve (shportës), në bashkëpunim me MSHKS dhe njësitë e qeverisjes vendore.
- Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe draft VKM-të po shtrojnë bazën ligjore, në mënyrë që sistemi të funksionojë.

Bashkitë kanë përgjegjësinë kryesore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Në këtë kuadër, bashkia e Dibrës merr përsipër hartimin e Planit Social, të prezantuar në këtë dokument. Përgjatë këtij procesi, ajo është mbështetur nga World Vision dhe ESA Consulting, në vlerësimin e nevojave lidhur me hartimin e planit, buxhetimin e tij dhe identifikimin e burimeve financiare për ta zbatuar, duke rritur kapacitetet vendore në këtë drejtim.

# 1. SHËRBIMET SHOQËRORE EKZISTUESE NË BASHKINË DIBËR

## 1.1. Shërbime ditore dhe komunitare

### 1.1.1. Shërbime për të moshuarit

- *Shërbimi ditor për të moshuarit*

Ky është një shërbim që është ofruar fillimisht nga Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Dibër dhe i mbështetur me mjedise nga Bashkia. Aktualisht të moshuarit frekuentojnë mjedisin për të kaluar kohën dhe për të luajtur si lojëra me domino apo letra, etj. Në qendër nuk ofrohen shërbime të tjera për të moshuar. Aktualisht frekuntohet nga rreth 20 të moshuar.

### 1.1.2. Shërbime për fëmijët

- *Aktiviteti NJMF-së pranë Bashkisë.*

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve që ka rreth 3 vite që është ngritur pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale ka hartuar dhe zbaton procedura si në raport me identifikimin dhe menaxhimin e rasteve specifike të fëmijëve në nevojë për t'u marrë në mbrojtje, ashtu edhe përsa i takon roleve të tjera si atyre ndërgjegjësuese, koordinuese etj. NJMF bën gjithashtu drejtimin e grupit multidisiplinar për ndjekjen e rasteve si ato të identifikuar nga vetë NJMF apo dhe raste të referuara nga aktorë të tjerë.

## 1.2. Shërbimet sociale të ofruara nga organizatat jofitimprurëse, bashkia Dibër

### WV ofron:

- shërbime ligjore falas ( nëpërmjet TLAS) për fëmijët me probleme të ndryshme që lidhen me situata të vështira ligjore,
- mbështetje në raste emergjencash me paketa ushqimore, veshje dhe mjete të tjera për jetesën dhe sigurinë për familjet me fëmijë, që jetojnë në kushte shumë të vështira.
- mbështetje të fëmijëve me probleme të shëndetit, me vizita, analiza, syze apo pajisje të tjera që përmirësojnë shëndetin e fëmijës, bazuar në rekomandimet e mjekut.

### ARSIS ofron:

- shërbime nëpërmjet TLAS për familjet rome dhe egjiptiane.

### Agritra-Vizion ofron:

- shërbim psikologjik dhe ligjor falas për vajzat dhe gratë e dhunuara.

### 1.3. Prioritetet në zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor

Bashkia e Dibrës, bazuar mbi vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e saj dhe përmes diskutimeve me stafin dhe aktorët relevante, janë identifikuar prioritetet e mëposhtme në zhvillimin e shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe atyre të reja dhe i reflekton ato në planin e veprimit 2018-2021:

#### Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese:

- Informimi i qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre dhe organizimi i dëgjësave publike me pjesëmarrje të qytetarëve
- Riorganizimi dhe përshkrimi i qartë i punës për punonjësit e drejtorisë së shërbimeve sociale dhe administratorët socialë
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara, në përgjigje të nevojave të qytetarëve

#### Zhvillimi i shërbimeve të reja:

- Ndërtimi i një qendre multifunksionale ku ofrohen një sërë shërbimesh për plotësimin e nevojave dhe trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Ndërtimi i një qendre sociale që ofron shërbime për fëmijët dhe të rinjtë
- Shërbime të emergjencës për dhunën në familje dhe mbrojtjen e fëmijëve
- Qendrave ditore komunitare për të moshuar në nivel bashkie
- Shërbime që kanë në fokus punësimin e të rinjve, grave dhe grupeve të ndryshme të marginalizuara

## 2. ANALIZA E AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

### 2.1. Situata e mbrojtjes shoqërore në bashkinë e Dibrës

Pjesëmarrësit si drejtuesi dhe stafi i DSHS-së, NJA-ve, përfaqësuesit e SHSR-së, si dhe OJF-të që veprojnë në territorin e bashkisë identifikojnë një sërë sfidash dhe nevoja prioritare në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror në këtë bashki:

- Bashkia Dibër nuk ka një plan të përkujdesit shoqëror apo një plan të mbrojtjes së fëmijëve. Të gjithë aktorët e intervistuar si drejtuesi dhe stafi i DSHS, NJA, përfaqësuesit e SHSR, përfituesit e shërbimeve si dhe OJF-të pjesëmarrëse në këtë vlerësim identifikojnë një sërë sfidash dhe nevojash, të lidhura me performancën në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, duke marrë parasysh edhe reformën territoriale dhe legjislacionin relevant, si më poshtë:
- Bashkia nuk ofron shërbime të përkujdesit shoqëror dhe shërbimet që ofrohen nga OJF-të janë të pakëta, të përkohshme dhe nuk mbulojnë nevojat e të gjithë përfituesve. Shërbimet që ofrohen nga OJF-të nuk janë të qëndrueshme duke qenë se ato mbështeten në fondet që ato sigurojnë nga donatorë të ndryshëm.
- Stafi i DSHS dhe NJA është i kufizuar dhe në kushtet e mbingarkesës në punë si dhe të mosnjohjes së roleve e përgjegjësive, linjave të raportimit, qasjes së nevojshme dhe formimit arsimor, nuk ofron as shërbimet ekzistuese të mundshme.
- Nevoja për të informuar qytetarët për ndryshimet që ndodhin në legjislacion shprehet si shqetësim nga përfaqësuesit e OJF-ve dhe kjo lidhet me pjesën e përgjegjësive dhe detyrimeve që kanë punonjësit e bashkisë.
- Mungesa e fondeve është një nga sfidat kryesore në ofrimin e shërbimeve, e identifikuar nga të gjithë pjesëmarrësit në vlerësim. Edhe përfaqësuesit e OJF e shohin si një shqetësim mungesën e një fondi nga bashkia si për rastet e emergjencës, menaxhimin e rasteve dhe zhvillimin e shërbimeve sociale.
- Mungesa e infrastrukturës raportohet si një pengesë nga të gjithë pjesëmarrësit. Mungesa e transportit kufizon lëvizjen dhe punën në terren të stafit të DSHS dhe NJA. Gjithashtu, largësia e qytetarëve nga zyrat shkakton vështirësi në procedurat për ndihmën ekonomike, në mungesë të transportit falas për ta. Për shumë familje të varfëra edhe aplikimi për dokumentacionin është i kushtueshëm dhe kthehet në faktorë pengues për aplikimin e familjes në skemën e NE.
- Mungesa e koordinimit mes aktorëve relevantë në sektorë të tjerë është një tjetër sfidë e identifikuar nga pjesëmarrësit. Mjaft pjesëmarrës raportojnë për mosnjohje të roleve e përgjegjësive prej këtyre aktorëve, të cilat çojnë në sfida të vazhdueshme në ndjekjen e rasteve.
- Edhe kontributi që ofrojnë OJF nuk merret gjithmonë në konsiderat dhe jo gjithmonë ka vullnet për organizmin e aktiviteteve të përbashkëta, duke koordinuar kapacitetet dhe ekspertizën që sjellin profesionistë të ndryshëm që vijnë nga shoqëria civile.

- Mungesa e kapaciteteve profesionale është një tjetër shqetësim që ngrihet edhe nga përfaqësues të OJF-ve, që e ndeshin gjatë menaxhimit të rasteve apo aktiviteteve të tjera që ju duhet të zhvillojnë në bashkëpunim me bashkinë apo NJA.
- Përfaqësuesit e OJF-ve raportojnë si shqetësim mungesën e transparencës dhe të dëgjësive publike për një pjesëmarrje të grupeve të ndryshme të interesit sipas çështjeve që miratohen apo adresohen në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.
- Stafit i DSHS dhe NJA është i fokusuar në ofrimin e shërbimeve si NE/AK dhe në menaxhimin e disa prej rasteve të mbrojtjes së fëmijëve apo dhunës në familje dhe shumë më pak i orientuar që të punoj me fokus tek individi dhe familja. Aksesit i qytetarëve në shërbime është i kufizuar duke qenë se mungojnë shërbimet, ndërkohë që nevoja për të ofruar shërbime edhe në nivel njësie administrative është e madhe.

## 2.2. Situata e grupeve vulnerabël dhe nevojat e tyre për shërbime

Të gjithë pjesëmarrësit raportojnë nevojën për ndërtimin e shërbimeve të reja të përkujdesit shoqëror nga bashkia, duke qenë se mungojnë shumë shërbime bazike që nevojitet t'iu përgjigjen nevojave shumëfishe dhe të paplotësuara deri më tani, të qytetarëve, fëmijë e të rritur. Nevojat prioritare për shërbime variojnë sipas grupeve të pjesëmarrësve, në përgjithësi ato përfshijnë:

- Ndërtimin e qendre multifunkionale ku ofrohen një sërë shërbimesh për plotësimin e nevojave dhe trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kjo është një nevojë që raportohet si nga punonjësit e DSHS dhe përfaqësuesit e OJF, duke qenë se numri i fëmijëve me AK është i lartë dhe mungojnë tërësisht shërbimet për këtë grup. Shumë e rëndësishme është edhe përshtatja e infrastrukturës për PAK me qëllim që të kenë mundësinë që të përfitojnë shërbime.
- Ndërtimi i një qendre sociale që ofron shërbime për fëmijët, të rinjtë duke qenë se bashkia disponon godina të ndryshme që mund të përshtaten për aktivitete të tilla.
- Ndërtimin e shërbimeve të reja për adresimin e rasteve të dhunës, si qendrat e emergjencës për pritjen e rasteve në nevojë për mbrojtje, apo ofrimi i shërbimeve 24 orëshe për ta.
- Disa nga pjesëmarrësit raportojnë nevojën për shërbime për të moshuarit, të cilat mungojnë për këtë kategori. Identifikohet nevoja për ndërtimin e të paktën një qendre rezidenciale për të moshuarit pa përkujdes, si dhe të qendrave ditore komunitare në nivel bashkie dhe njësie administrative që ofrojnë shërbime bazë si socializimi dhe shërbimet shëndetësore. Ka një ambient që përdoret për të moshuarit që thjeshtë luajnë letra, domino por që nuk ofron asnjë shërbim tjetër për këtë grup target.
- Shërbime që kanë në fokus punësimin e të rinjve, grave dhe grupeve të ndryshme të marginalizuara është një tjetër çështje me interes e ngritur nga të gjithë pjesëmarrësit. Edhe sipas raporteve zona e Dibrës është nga zonat më të varfëra dhe me numrin më të lartë të papunësisë në Shqipëri. Shumica e popullsisë kryesisht në zonën rurale dhe atë urbane trajtohen me ndihmë ekonomike. Shkalla e papunësisë në zonën e Dibrës mbetet shume e lartë në vlerë absolute dhe në raport me mesataren e vendit. Papunësia është veçanërisht e theksuar

tek të rinjtë dhe tek femrat. Norma e rregjistruar e papunësisë për zonën e Dibrës është e lartë (16%). Dinamika e papunësisë në zonë është në rënie me 43% krahasuar me vitin 2002 (28%)<sup>2</sup>.

- Krijimi i mundësive për strehim social të familjeve nga komuniteti Rom dhe Egjiptian dhe grupet e tjera në nevojë. Bashkia ka në inventarin e saj prona (asete) të cilat mund të përshtaten dhe të vihen në përdorim për këtë grupet në nevojë.

### 2.3 Partneriteti me OJF-të

OJF-të kanë një rol shumë të rëndësishëm në advokimin për problematika të ndryshme, hartim politikash dhe shpërndarje të shërbimeve. Në Dibrë operojnë disa organizata të shoqërisë civile nga të cilat pak ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për mbrojtjen e fëmijëve dhe pjesa më e madhe realizojnë aktivitete fuqizuese për zhvillimin e komuniteteve apo target grupeve të caktuara, si gratë, komunitetin rom dhe egjiptian, fëmijët si edhe familjet e varfra.

Disa nga OJF-të që ofrojnë aktualisht shërbime janë World Vision me shërbime ligjore falas, mbështetje në raste emergjencash me paketa ushqimore, veshje dhe mjete të tjera, mbështetje të fëmijëve me probleme të shëndetit, me vizita, analiza, syze; ARSIS që ofron shërbime nëpërmjet TLAS për familjet rom dhe egjiptiane; Agritra-Vizion që ofron shërbim psikologjik dhe ligjor falas për vajzat dhe gratë e dhunuara. Roli i OJF-ve është thelbësor në lidhje me hartimin e politikave dhe shpërndarjen e shërbimeve shoqërore si dhe në targetimin e nevojave sipas grupeve kryesore me të cilat ata punojnë.

DSHS bashkëpunon drejtpërsëdrejti me OJF sipas aktiviteteve dhe grupeve target që ato kanë në fokus dhe për njërin prej tyre ka ofruar edhe mjedise zyre. OJF-të konsiderohen si një strukturë e rëndësishme në ofrimin e shërbimeve, pasi mund të veprojnë edhe më shpejt se institucionet publike dhe kanë mundësi për të ofruar një cikël të plotë të shërbimeve. Bashkia Dibrë duhet të ndërtojë sisteme dhe mekanizma referimi të cilat të përfshijnë edhe OJF-të lokale si aktorë shumë të rëndësishëm. OJF-të raportojnë nevojën për një marrëdhënie bashkëpunimi të qëndrueshme me bashkinë në kuadër edhe të nevojave që identifikohen nga vet OJF me grupet target me të cilat ato punojnë dhe planifikimit të shërbimeve bazuar në nevojat e komunitetit. Përfaqësuesit e OJF-ve shprehin të shqetësuar se bashkia jo gjithmonë ka informacion për punën që bëjnë OJF-të, edhe pse në mungesë të shërbimeve i duhet të mbështetet herë pas here në shërbimet e ofruara prej tyre. Nga ana tjetër, organizatat janë gjithmonë në kërkim të fondeve dhe burimeve dhe në varësi të disponueshmërisë së tyre, ato nuk janë gjithmonë aktive. Në lidhje me punën e organizatave deri tani nuk është hartuar ndonjë marrëveshje formale apo ndonjë plan bashkëpunimi, pa përcaktuar kështu ndonjë përgjegjësi.

---

<sup>2</sup> Ministria e Zhvillimit Urban (2016). Planet e Përgjithshme Vendore, Analiza Social-Ekonomike, Bashkia Diber



### 3. TREGUESIT SOCIALË

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 61,619 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 78,598 banorë<sup>3</sup>. Tabela mëposhtë tregon numrin e familjeve dhe numrin e banorëve për cdo njësi administrative:

Nr	2016	Popullsia	Nr Familje
1	Bashkia Peshkopi	19222	5358
2	Komuna Arras	3688	1158
3	Komuna Fushë Cidhen	3483	1067
4	Komuna Fushë Muhur	3439	1040
5	Komuna Kala e Dodës	2845	806
6	Komuna Kastriot	7407	2145
7	Komuna Lurë	1390	479
8	Komuna Luzni	3184	959
9	Komuna Maqellare	13817	3659
10	Komuna Melan	4402	1184
11	Komuna Tomin	8504	2312
12	Komuna Selishtë	1877	573
13	Komuna Slllove	3015	940
14	Komuna Zall Dardhë & Zall Rec	2325	706
	<b>RRETHI DIBER</b>	<b>78598</b>	<b>22386</b>

Treguesit demografik të mbledhura nga INSTAT janë siguruar nga publikimi i popullsisë në shkurt 2017.

Rajoni	Numri i fëmijëve sipas grupmoshës, gjinisë dhe qarqeve												
	Totali i fëmijëve 0-18 vjeç	0-4 vjeç			5-9 vjeç			10-14 vjeç			15-19 vjeç		
		Tot al	Fem ra	Mesh kuj	Tot al	Fem ra	Mesh kuj	Tot al	Fem ra	Mesh kuj	Tot al	Fem ra	Mesh kuj
<b>Dibër</b>	36471	9191	4391	4800	8233	3911	4322	8660	4079	4581	10387	4918	5469

Nga përlogaritjet e popullsisë në 1 Janar 2018 rezulton se Dibra kishte Ulje të mëdha të popullsisë me (-36,6 për 1000 banorë)<sup>4</sup>

Qarku	1 Janar 2017			1 Janar 2018		
	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej

<sup>3</sup> Të dhëna nga Bashkia Diber

<sup>4</sup> [http://ëëë.instat.gov.al/media/3765/popullsia-1-janar-2018-08-02-2018\\_.pdf](http://ëëë.instat.gov.al/media/3765/popullsia-1-janar-2018-08-02-2018_.pdf)

<b>Dibër</b>	65.742	59.837	125.579	63.083	57.895	120.978

### Arsimi

Arsimi luan një rol të rëndësishëm në jetën e fëmijëve, pasi ju mundëson zhvillimin e personalitetit, talentit, aftësisë mendore dhe fizike, për të arritur në potencialet tyre e mundshme. Aktualisht Bashkia Dibër ka 74 kopshte, 116 shkolla 9-vjeçare (vetëm 1 shkollë private) dhe 9 shkolla të mesme.

Rajoni	Numri total dhe përqindja e nxënësve që përfundojnë arsimin fillor 2015-2016 sipas qarqeve dhe gjinise					
	Numer			Përqindja		
	Total(F+M)	Femra	Meshkuj	Total(F+M)	Femra	Meshkuj
<b>Dibër</b>	8866	4031	4835	99.2%	99.3%	99.1%

Burimi: Vjetari Statistikorë për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve për vitin 2016, përgatitur nga ASHMDF

Rajoni	Numri i fëmijëve në klasë në Ciklin e Ulët
<b>Dibër</b>	8630

Burimi: Vjetari Statistikorë për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve për vitin 2016, përgatitur nga ASHMDF

### Çerdhet dhe kopshtet

Bashkia Dibër ka 3 çerdhe që ndodhen në NJA Peshkopi.

Numri i kopshteve për rajonin e Dibrës është 158.

Rajoni	Numri i kopshteve dhe i edukatoreve sipas qarqeve	
	Kopshte	Edukator
<b>Dibër</b>	158	267

Numri i fëmijëve 0-3 vjeç që shkojnë në çerdhe sipas gjinisë dhe qarqeve

NR	Bashkite	Numri i femijeve 0-3 vjeç që shkojnë në çerdhe
----	----------	--

		sipas gjinise		
		Total(F+M)	Femra	Meshkuj
<b>1</b>	Bashkia Dibër	104	49	55

Burimi: Vjetari Statistikorë për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve për vitin 2016, përgatitur nga ASHMDF

Raporti fëmijë /edukator në çerdhe dhe kopshtet publike e private

NR	Bashkite	Raporti fëmijë/edukator ne çerdhet
<b>1</b>	Bashkia Dibër	5.7 femije/1 edukator

Burimi: Vjetari Statistikorë për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve për vitin 2016, përgatitur nga ASHMDF

Rajoni	Raporti fëmijë/edukator në kopshtet publike e private	
	Kopshte	
	Publike	Private
<b>Dibër</b>	16.4	0.0

Burimi: Vjetari Statistikorë për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve për vitin 2016, përgatitur nga ASHMDF

### Shëndetësia

Përqindja më e lartë e fëmijëve deri 1 vit të imunizuar me të gjitha vaksinat 100% vlerësohet në rajoni e Dibrës, sipas të dhënave nga raporti i Vjetari Statistikorë për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve për vitin 2016, përgatitur nga ASHMDF.

Treguesit e mëposhtëm në lidhje me shëndetësinë i referohen viti 2015.

Komuna/Bashkia	Popullsia	nr Infermiereve	% infermiereve	Nr mjekëve	% mjekëve	NrFamilje
Bashkia Peshkopi	19185	29	0.15	6	0.03	5183
Komuna Arras	3763	14	0.37	1	0.03	1135
Komuna Fushë Cidhen	3562	10	0.28	1	0.03	1019
Komuna Fushë Muhur	3463	13	0.38	1	0.03	1031

Komuna Kala e Dodës	3016	9	0.30	1	0.03	833
Komuna Kastriot	7391	20	0.27	2	0.03	2055
Komuna Lurë	1468	8	0.54	1	0.07	492
Komuna Luzni	3170	9	0.28	1	0.03	933
Komuna Maqellare	13741	42	0.31	3	0.02	3501
Komuna Melan	4390	19	0.43	1	0.02	1126
Komuna Tomin	8517	29	0.34	3	0.04	2232
Komuna Selishtë	1966	8	0.41	1	0.05	568
Komuna Slllove	3098	14	0.45	1	0.03	959
Komuna Zall Dardhë- Zall Rec	2395	13	0.54	2	0.08	712
Rrethi Diber	79125	237	0.30	25	0.03	21779

Nr	Njesia vendore	Nr. vizitave në konsultoret e gruas gjatë një viti (nr)	Nr. vizitave në konsultoret e fëmijës gjatë një viti (nr)	Shkalla e imunizimit	Vdekshmëria foshnjore 0-1 vjeç (nr)	Vdeks hmëria e fëmijëve 0-5 vjeç (nr.)	Numri mjekëve	Numri Infermierëve	Regjistrimi në lindje (nr.)	Përqindja e lindjeve të gjalla nën peshë
1	Bashkia Peshkopi	773	1765	100%	1		6	29	162	1.4
2	Tomin	727	908	100%	0		3	29	49	15.5
3	Melan	316	362	100%	0		1	19	103	1.5
4	Maqellare	2378	3758	100%	2		3	42	152	1.5
5	Muhur	275	300	100%	1		1	13	37	10.5
6	Luzni	150	168	100%	0		1	9	112	9.1



7	Selishte	0	0	0	0	0	0	0	6	6
8	Kastriot	0	1	0	0	0	0	0	7	7
9	F-Çidhën	0	0	0	0	0	0	0	3	3
10	Silove	0	0	0	0	0	0	0	10	10
11	Kala e Dodes	0	0	0	0	0	0	0	2	2
12	Arras	0	0	0	0	0	0	0	9	9
13	Zall-Dardhë	0	0	0	0	0	0	0	5	5
14	Zall-Reç	0	0	0	0	0	0	0	9	9
15	Lurë	0	0	0	0	0	0	0	1	1
	<b>Rrethi Dibër</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>10</b>	<b>14</b>	<b>106</b>	<b>106</b>

### PAK

Numri i personave me aftësi të kufizuara të rregjistruar dhe që përfitojnë nga pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar në Bashkinë Dibër është 2472 persona, nga të cilët 108 (ose 4.2%) janë fëmijë me aftësi të kufizuara. 30 prej përfituesve janë persona të verbër dhe 40 para e tetraplegjikë (prej tyre 1 fëmijë i verbër dhe 7 fëmijë me statusin e tetra-paraplegjikut). Ndërkohë raportohen 239 persona me probleme të ndërthurura mendore dhe fizike nga të cilët 68 janë fëmijë. Gati 4.2% e përfituesve nga skemat e pagesave të mbrojtjes sociale për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Dibër janë fëmijë të moshës 0-18 vjeç (n=108). 64 persona janë edhe përfitues të pagesës së kujdestarisë nga të cilët 32 janë fëmijë dhe 40 përfitojnë paketë higjieno-sanitare nga të cilët 7 janë fëmijë. Numri i përfituesve nga skemat e Sigurimeve Shoqërore për invalidët e punës në Bashkinë Dibër është 1331<sup>5</sup>.

Nr	Emer Institucionit	2017							
		Persona me PAK gjithesej						Numri i kujdestareve	
		Gjithsej	100%	150%	200%	300%	Nga keto:Rom	Gjithsej	100%
1	Peshkopi	328	317	6	5	0	0	48	48
2	Qender Tomin	184	174	0	7	3	0	12	12
3	Melan	92	92	0	0	0	0	8	7

<sup>5</sup> ËV, FSHDPAK (2017). Plan lokal Për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në bashkinë Dibër

4	Kastriot	176	170	0	3	3	0	18	18
5	Lure	39	39	0	0	0	0	4	4
6	Maqellare	219	219	0	0	0	0	21	21
7	Muhurr	85	85	0	0	0	0	8	8
8	Selishte	51	51	0	0	0	0	3	3
9	Sillove	88	83	3	0	2	0	9	9
10	Kala e Dodes	65	64	0	0	1	0	6	6
11	Zall Dardhe	38	38	0	0	0	0	4	4
12	Zall Rec	32	32	0	0	0	0	7	7
13	Fushe Cidhen	89	85	1	2	1	0	9	9
14	Arras	90	86	0	2	2	0	5	5
15	Luzni	99	98	1	0	0	0	8	8

Burimi: Bashkia Dibër

### Ndihma ekonomike

Ndihma kryesore që u vjen në ndihmë familjeve në nevoj nga bashkia Dibër është përmes skemës së ndihmës ekonomike.

EMERTIMI		Numri i familjeve që perfitojnë ndihmë ekonomike 2017	
		Ndihme e pjesëshme	Ndihmë e plotë
Bashkia Peshkopi	731	364	367
Komuna Qender Tomin	829	829	-
Komuna Melan	416	416	-
Komuna Kastriot	762	762	-
Komuna Lure	210	210	-
Komuna Maqellare	1,254	1,254	-
Komuna Fushe Muhure	469	469	-
Komuna Selishte	255	255	-
Komuna Sillove	416	416	-
Komuna Kala e Dodes	359	359	-

Komuna Zall Dardhe	176	176	-
Komuna Zall Reç	181	181	-
Komuna Fushe Cidhen	453	453	-
Komuna Arras	440	440	-
Komuna Luzni e Vogel	485	485	-
Gjithsej Bashkite	731	364	-
Gjithsej Komunat	6,705	6,705	-
Totali i Rrethit Diber	7,436	7,069	367

Burimi: Bashkia Dibër

### Fëmijë të denoncuar për krime

Treguesit e Drejtësisë për të Miturit mblidhen dhe raportohen çdo vit nga Drejtoria Përgjithshme të Policisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës. Këta tregues japin një informacion mbi numrin e fëmijëve të përfshirë në vepra penale dhe të natyrës së veprave penale të kryera.

Rajoni	1.Numri i fëmijëve të denoncuar sipas llojit të veprës			
	Krime të hapura			
	Total krime të hapura	Krim kundër personit	Krim kundër pronës	Krime të tjera
<b>Dibër</b>	48	16	19	13

Burimi: Vjetari Statistikorë për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve për vitin 2016, përgatitur nga ASHMDF

### Papunësia

Një analizë mbi baza rajonale<sup>6</sup>, tregon që në vitin 2016, shkalla e papunësisë në Dibër është 8.6%. Struktura e punësimit sipas qarqeve dhe sektorëve të ekonomisë në 2016 për Dibrën është 69% në Bujqësi-Agrikulturë, 10% Industri dhe 21% shërbime.

<sup>6</sup> INSTAT (2016). Tregu I punës



## 4. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL

### 4.1. Misioni

Bashkia Dibër synon që të përcaktojë objektivat strategjike për një periudhë 4-vjeçare dhe të konsolidojë sektorin e shërbimeve sociale duke ofruar më shumë shërbime sociale për popullatën bazuar në vlerësimin e nevojave. Ky mision synon të përmbushet përmes zhvillimit të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe ndërtimit të shërbimeve të reja, mbështetur në kuadrin ligjor dhe praktikat më të mira bashkëkohore.

### 4.2. Vizioni

Shërbimet sociale në Dibër do të kenë një fokus gjithëpërfshirës, në përputhje me nevojat e komunitetit, me standarde, të besueshme dhe pranë njerëzve duke mbuluar nevojat më emergjente të komunitetit. Bashkia e Dibrës do të ngrëjë një sistem të balancuar shërbimesh sociale për të adresuar sa më mirë nevojat e komunitetit në bashkëpunim me grupet e ndryshme të interesit. Bashkia e Dibrës do të ngrëjë një sistem të balancuar shërbimesh sociale të cilat do të kenë në fokus grupet në nevojë, duke synuar një mbulim më të mirë të nevojave ekonomike të tyre, një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të përkujdesit shoqëror nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe ndërtimit të shërbimeve të reja sipas modeleve të praktikave të mira bashkëkohore.

DRK

## 5. Strategjia e zbatimit të planit social

### Monitorimi dhe Vlerësimi (MV)

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit është të sigurohemi që plani social i bashkisë Dibër po zbatohet sipas afateve dhe synimeve të caktuara dhe për të kontrolluar pajtueshmërinë e standardeve të përcaktuara me ato që po zbatohen në realitet.

Monitorimi është procesi i vazhdueshëm i mbledhjes së të dhënave dhe matjes së progresit drejt arritjes së objektivave strategjike dhe specifike të këtij Plani Social. Monitorimi siguron mbledhjen sistematike të të dhënave në lidhje me zbatimin e këtij plani për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm. Monitorimi dhe vlerësimi është një pjesë kritike e menaxhimit të mirë të programit dhe llogaridhënies. Përmes monitorimit, zbatuesit dhe aktorët përgjegjës për këtë plan sigurohen që aktivitetet që kryhen janë në përputhje me ato të planifikuara dhe brenda afateve kohore të përcaktuara. Gjithashtu monitorimi parashikon edhe marrjen e masave korigjuese ku ka devijime si edhe bën të mundur parashikimin e vështirësive para se të shfaqen.

Monitorimi kryhet në intervale kohore të ndryshme: mujore, tre-mujore, gjashtë-mujore, vjetore dhe kërkon informacion nga tre fusha kryesore:

1. Inputet, burimet që përdoren për realizimin e planit, që përfshijnë stafin, financat, materialet dhe kohën;
2. Proceset, numri i aktiviteteve ku përdoren burime njerëzore dhe financiare për të arritur rezultatet e pritshme të planit;
3. Outpute/produkte/shërbime, rezultatet e menjëhershme që përftohen përmes realizimit të aktiviteteve.

Në dallim nga monitorimi, ku të dhënat mbledhen periodikisht dhe përdoren për të matur progresin, vlerësimi është një analizë e detajuar e planit që synon të rishikojë arritjet e planit përkundrejt pritjeve të planifikuara, dhe të përdorë eksperiencën e fituar për të përmirësuar hartimin e planeve në të ardhmen. Vlerësimi fokusohet në rezultate duke marrë në konsideratë inputet (burimet); rezultatet në lidhje me koston; procesin e përdorur për të arritur rezultatet; relevancën e përgjithshme; ndikimin; dhe qëndrueshmërinë. Vlerësimi identifikon efektet dhe ndikimet e performancës së planit duke u fokusuar në analizën e progresit drejt arritjes së objektivave.

Përgjegjëse për monitorimin e zbatimit e planit social do të jetë DSHS, të cilët mbledhin të dhëna dhe identifikojnë boshllëqet në informacionin që nevojitet. Ajo do të ketë gjithashtu rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit dhe do të ketë përgjegjësinë e përgatitjes së progres raporteve vjetore. Plani parashikon veprimtari të përmirësimit të sistemit të të dhënave, hartimit të instrumentave të standartizuara të raportimit dhe MV, si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit me strukturat e nivelit rajonal, qendror dhe OJF-të.

Një vëmendje e veçantë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të planit social do të kushtohet ngritjes

së kapaciteteve të punonjësve të institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për të garantuar mbledhjen e të dhënave të nevojshme duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë të grupeve të targetuara. Gjithashtu Bashkia do të koordinojë procesin e mbledhjes së të dhënave nga të gjitha NJA, OJF-të dhe aktorët e tjerë vendor e rajonal të monitorimit dhe vlerësimit të arritjes së objektivave të saj. Bashkia do të lehtësojë gjithashtu koordinimin me organizatat ndërkombëtare, të cilat adresojnë çështjet e grupeve në nevojë përmes programeve të tyre.

Cikli i monitorimit dhe vlerësimit do të përfshijë:

- Vlerësimin formues të progresit dhe rishikimin e veprimeve të parashikuara në mes të afatit, në periudhën 2019-2020.
- Pas vlerësimit formues të progresit, Bashkia do të bëjë rishikimin dhe përditësimin e masave të planit social për grupet e targetuara, duke patur parasysh edhe planifikimet buxhetore deri në vitin 2021.
- Një vlerësim përfundimtar që do të bëhet në fund të 2021, ku do të përcaktohet çdo çështje e pazgjidhur dhe zhvillime që mbeten për t'u realizuar.

Baza kryesore e kuadrit monitorues të Planit Sociale 2017-2021, do të jetë lista e treguesve të monitorimit e paraqitur për secilin objektiv dhe aktivitet në Planin e Veprimit.

Instrumenti kryesor në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të planit social do të jetë Raporti Vjetor i Shërbimeve Sociale, i përgatitur nga DSHS në Bashkinë e Dibrës.

**Objektivi strategjik 1. Fuqizimi, organizimi, koordinimi i shërbimeve sociale në Bashkinë Dibër**

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi	Monitorimi
<b>Objektivi specifik 1 – Strukturimi dhe forcimi i drejtorisë së shërbimeve sociale dhe koordinimi me aktorët lokal</b>						
Finalizimi i strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale	DSHS		Struktura e ngritur	Legjislacioni përkatës në fuqi		DSHS
Diskutimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës të stafit të DSHS	DSHS		Përshkrimi i punës i miratuar për punonjësit DSHS	Legjislacioni përkatës në fuqi		DSHS
Krijimi i një praktike bashkëpunimi përmes tryezave konsultative për adresimin e nevojave të komunitetit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale	DSHS OJF lokale Aktorë të tjerë lokal		Numri i tryezave konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Dibrës; Numri i pjesëmarrësve në takime;	Adresari i OJF-ve	Bashkia Dibër OJF lokale	DSHS
<b>Objektivi specifik 2. Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në çdo njësi administrative</b>						
Rishikimi i strukturës së NJVNR për çdo NJA sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbime	DSHS NJA		Numri i NJVNR të ngritura Numri i stafit të ri të punësuar	Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror Legjislacioni përkatës në fuqi		MSHKS DSHS
Diskutimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës për NJVNR	DSHS		Përshkrimet e punës për të gjithë profesionistët	Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror Legjislacioni		DSHS

				përkatës në fuqi		
Krijimi dhe përditësimi i hartës vendore dhe adresarit të shërbimeve/projekteve vendore për individët dhe familjet në nevojë	DSHS		Dokumenti i hartës vendore dhe i adresarit, të përditësuar çdo vit	Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror Legjislacioni përkatës në fuqi		DSHS
<b>Objektivi specifik 3. Ngritja e NJMF-ve në NJA sipas përcaktimit në ligj</b>						
Ngritja e strukturës së NJMF-së në çdo NJA (1 Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve - PMF për çdo NJA - të pangarkuar me role të tjera në çdo NJA që ka mbi 3000 fëmijë)	DSHS		Numri i strukturave të ngritura në raport me numrin e fëmijëve në zonë (sipas ligjit)	Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”		DSHS
Diskutimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës për PMF	DSHS		Përshkrimi i punës i miratuar për PMF në NJA	Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”		DSHS
Ngritja e grupit teknik multidisiplinar (GTM) të trajtimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe forcimi i punës së GTM	DSHS Institucionet përgjegjëse, pjesë e grupit teknik multidisiplinar		Dokumenti i miratimit të GTM Numri i takimeve të GTM	Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”		DSHS

<b>Objektivi specifik 3. Zhvillimi i monitorimit dhe vlerësimit</b>						
Vlerësimi dhe përcaktimi i procedurave për prokurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas kuadrit rregullator	Agjencia e prokurimeve e publike		Dokumenti i procedurave	Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror		DSHS
Përcaktimi i kriterëve, procedurave dhe përgjegjësi për zbatimin dhe monitorimin e Fondit Social	MSHKS DSHS		Dokumenti i procedurave	Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror	MSHKS	MSHKS DSHS

### Objektivi strategjik 2. Ngritja e shërbimeve të reja dhe përmirësimi i shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi	Monitorimi
<b>Objektivi specifik 1. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara<sup>7</sup></b>						
Përditësimi i statistikave për PAK në përputhje me indikatorët e startegjive	DSHS		Instrumentat e rinj të përpiluar për mbledhjen e të dhënave; Baza e të dhënave në dispozicion;	Startegjia e Përfshirjes Sociale, Mbrojtjes Sociale Plani i Veprimit për PAK VKM e statistikave		MSHKS DSHS

<sup>7</sup> Për më shumë informacion shiko: WV, FSHDPAK (2017). Plan lokal Për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në bashkinë Dibër

				për PAK		
Mbledhja e statistikave në përputhje me Regjistrin e ri Elektronik dhe me kriteret e reja të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.	DSHS		Regjistri i ri elektronik	Startegjia e Përfshirjes Sociale, Mbrojtjes Sociale Plani i Veprimit për PAK VKM e statistikave për PAK		DSHS
Vlerësimi i nevojave për planifikimin dhe ngritjen e një qendre multifunkionale për fëmijët me AK dhe kostimi i tij	DSHS		Dokumenti i vlerësimit të nevojave, studim i feabilitetit	Legjislacioni përkatës në fuqi		DSHS
Vënia në funksion e qendrës multifunkionale për fëmijët me AK	DSHS		Numri i stafit Numri i shërbimeve Numri i përfituesve	Legjislacioni përkatës në fuqi në fuqi		DSHS
<b>Objektivi specifik 2. Ngritja e një qendre sociale që ofron shërbime për fëmijët dhe të rinjtë</b>						
Vlerësimi i nevojave për planifikimin dhe ngritjen e një qendre sociale që ofron shërbime për fëmijët dhe të rinjtë dhe kostimi i tij	DSHS		Dokumenti i vlerësimit të nevojave, studim i feabilitetit	Legjislacioni përkatës në fuqi në fuqi		DSHS
Vënia në funksion e qendrës sociale për fëmijët dhe të rinjtë	DSHS		Numri i stafit Numri i shërbimeve Numri i përfituesve	Legjislacioni përkatës në fuqi në fuqi		DSHS
<b>Objektivi specifik 3. Ngritja e strehzës së emergjencës për dhunën në familje dhe mbrojtjen e fëmijëve</b>						

Vlerësimi i nevojave për planifikimin dhe ngritjen e strehzës së emergjencës dhe kostimi i tij	DSHS		Dokumenti i vlerësimit të nevojave – studim i feasibilitetit	Legjislacioni përkatës në fuqi në fuqi		DSHS
Vënia në funksion e strehzës së emergjencës	DSHS		Dokumenti i vlerësimit të nevojave – studim i feasibilitetit	Legjislacioni përkatës në fuqi në fuqi		DSHS
<b>Objektivi specifik 4. Qendrave ditore komunitare për të moshuar në nivel bashkie</b>						
Shtimi i kapacitetit të qendrës ditore për të moshuar; pasurimi i aktivitetit social të saj.	DSHS		Numri i përfituesve Numri i aktiviteteve të zhvilluara	Legjislacioni përkatës në fuqi në fuqi		DSHS
Përmirësimi i infrastrukturës	DSHS		Infrastruktura e përmirësuar	Legjislacioni përkatës në fuqi në fuqi		DSHS
<b>Objektivi specifik 5. Rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe efektivitetin në menaxhimin e rasteve</b>						
Krijimi i bazës logjistike të nevojshme për lëvizshmërinë e strukturave përgjegjëse për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje	DSHS		Mjetet e transportit në dispozicion Mjetet e komunikimit në dispozicion	Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”		DSHS
Bashkëpunimi me institucionet publike për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje	DSHS		Numri i bashkëpunimeve Numri i rasteve të referuara	Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”		DSHS
Ngritja/funksionimi i vazhdueshëm i qendrës së	DSHS		Mjedisi i qendrës së emergjencës i ndërtuar	Ligji “Për të drejtat dhe		DSHS



emergjencës/pritëse për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje				mbrojtjen e fëmijëve” Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror		
Hartimi dhe zbatimi i Planit Individual të menaxhimit të rastit për çdo fëmijë në nevojë	DSHS		Numri i planeve individuale të hartuara Numri i takimeve për menaxhimin e rasteve	Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”		DSHS

### Objektivi strategjik 3. Zbutja dhe lehtësim i varfërisë

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi	Monitorimi
<b>Objektivi specifik 1. Lehtësimi dhe zbutja e varfërisë</b>						
Identifikimi i familjeve aplikante, të cilat nuk përfitojnë nga skema e NE	DSHS NJA		Numri i familjeve të identifikuara	Raportet nga sistemi MIS i NE Vlerësimi socio-ekonomik për familjet jo përfituese		DSHS Bashkia
Miratimi i kriterëve për përzgjedhjen e familjeve që do të përfitojnë nga 6% dhe fondet e Bashkisë	Këshilli Bashkiak DSHS NJA		Lista e kriterëve të përzgjedhjes Numri i familjeve përfituese	Legjislacioni përkatës në fuqi për NE		DSHS Bashkia
Punësimi për kategoritë në nevojë (familjet përfituese të	DPSHS		Numri i personave të punësuar	Sistemi i NE		SHSHS Bashkia

NE, gratë kryefamiljare dhe të rinjtë, grupet e marginalizuara nga komuniteti Romë dhe Egjiptianë)						
Alokimi i kuotave për të çuar në kopshte dhe çerdhe fëmijët në nevojë për mbrojtje	DMS		Vendim i Këshillit Bashkiak për alokimin e kuotave Numri i fëmijëve që përfitojnë nga kuotat	DSHS NJA		DSHS

#### Objektivi strategjik 4. Kualifikimi i stafit

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi	Monitorimi
<b>Objektivi specifik 1. Rritja e kapaciteteve të stafit për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror</b>						
Trajnime mbi funksionimin e NVRR.	DSHS		Moduli i trajnimit Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i profesionistëve të trajnuar	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror;		DSHS
Trajnime mbi zbatimin dhe monitorimin e Fondit Social.	DSHS		Moduli i trajnimit Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i stafit të trajnuar	Legjislacioni në fuqi; Ligji i shërbimeve të përkujdesit shoqëror; Dokumente		DSHS

				të praktikave të mira;		
Trajnime për planifikimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale.	DSHS		Moduli i trajnimit Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i stafit të trajnuar	Legjislacioni në fuqi; Ligji i shërbimeve të përkujdesit shoqëror; Dokumente të praktikave të mira;		DSHS
Trajnime për njohjen dhe përditësimin me ndryshimet ligjore, rregulloret e reja dhe procedurat.	DSHS		Moduli i trajnimit Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i stafit të trajnuar	Legjislacioni në fuqi; Ligji i shërbimeve të përkujdesit shoqëror; Dokumente të praktikave të mira;		DSHS
Trajnime mbi menaxhimin e rasteve (vlerësimin dhe referimi).	DSHS		Moduli i trajnimit Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i stafit të trajnuar	Legjislacioni në fuqi; Ligji i shërbimeve të përkujdesit shoqëror; Dokumente		DSHS

				të praktikave të mira;		
Trajnime për ofrimin e shërbimeve të bazuara në qasjen multidisiplinare.	DSHS		Moduli i trajnimit Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i stafit të trajnuar	Legjislacioni në fuqi; Ligji i shërbimeve të përkujdesit shoqëror; Dokumente të praktikave të mira;		DSHS
Trajnim mbi funksionim e qendrës së emergjencave	DSHS		Moduli i trajnimit Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i stafit të trajnuar	Legjislacioni në fuqi; Ligji i shërbimeve të përkujdesit shoqëror; Dokumente të praktikave të mira;		DSHS
Trajnim mbi funksionim e qendrës multifunksionale për fëmijët me AK	DSHS		Moduli i trajnimit Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i stafit të trajnuar	Legjislacioni në fuqi; Ligji i shërbimeve të përkujdesit shoqëror; Dokumente		DSHS

				të praktikave të mira;		
Trajnim mbi funksionim qendrës sociale që ofron shërbime për fëmijët dhe të rinjtë	DSHS		Moduli i trajnimit Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i stafit të trajnuar	Legjislacioni në fuqi; Dokumente të praktikave të mira;		DSHS

DRAFT